

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ADRIATIC UNION” shpk

Sot, me date 28.02.2022, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04. 2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te nenshkruarit:

1. **Z.PETRIT KOVAÇI**, atesia Hysen, i datelindjes 05.04.1952, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, lindur dhe banues ne Durres ne adresen; Lagja Nr.1 Durres, mbajtes i dokumentit te identifikimit *pasaporte BA7076535/F20405125M*, me afat deri me 17.07.2025.
2. **SHOQERIA “T.O.V 2019” SHPK**, me NUIS L91713025B, e rregjistruar si person juridik me daten 13.05.2019, me qender te shoqerise ne adresen; Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga “Gjeneral Nikolas”, ZK 8280, pasuria nr.2/55 Tirane, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z. Genti Klosi, mbajtes i dokumentit te identifikimit *Leternjoftim ID 037712170/I30813064P*, me afat deri me 22.09.2031.
3. **SHOQERIA “USHINA” shpk**, me NUIS K11717501T, e rregjistruar si person juridik më datë 17.05.2001, me qender të Shoqërisë në adresën; Lagja Nr.16, Rr. “Hysen Kertusha”, Kati 4, objekti “Big-Bar” Durrës, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise **Z.Fatjon Ushina**, mbajtes i dokumentit te identifikimit *Leternjoftim ID H51001144J*.

Si themelues te shoqerise tregtare “ADRIATIC UNION” shpk, sot me date 28 Shkurt 2022, duke patur zotesine ligjore per te vepruar, perpilojne kete Akt Themelimi, me kete permbajtje si me poshte vijon:

Neni 1:

FORMIMI

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **Shoqeria “ADRIATIC UNION” shpk**.

Neni 2:

SELIA

Selia e Shoqerise Tregtare “ADRIATIC UNION” shpk eshte ne Durres ne adresen: Lagja Nr.16, Rr. “Hysen Kertusha”, Kati 4, objekti “Big-Bar” Durres, Shqiperi.

Neni 3:

KOHEZGJATJA

Shoqeria Tregtare “ADRIATIC UNION” shpk ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 4:

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria me Përgjegjësi të Kufizuar “ADRIATIC UNION” shpk do të ketë për objekt aktiviteti, si me poshtë: “Hoteleri, turizem, agjensi turistike, bar, restorante, plazh dhe/ose shazllona me qera, sporte ujore, import, eksport dhe tregtim me shumice e pakice të mallrave të ndryshme industriale, artikujve ushqimore, blegtorale, bujqësore dhe të çdo lloj malli tjetër të lejuar për tregtim, marrveshje kontraktore me persona fizike dhe/ose juridike vendas dhe të huaj për zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit të përbashkët me to si dhe pjesëmarrja në tendera brenda dhe jashtë vendit, internet, bar-restorant-piceri, çadra plazhi, si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm lidhur me objektin e veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 5:

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali Themeltar i Shoqerisë është në likuiditet në shumën: **100.000 Leke** (njëqindemije) Leke, i formuar dhe nënshkruar nga Ortaket themelues sipas këtij kontributi:

- **Ortaku Z.PETRIT KOVAÇI** kontribues me shumën **50.000 Leke**, që zënë **50%** të Kapitalit,
- **Ortaku SHOQERIA “T.O.V 2019” SHPK**, me NUIS L91713025B, kontribues me shumën **25.000 Leke**, që zënë **25%** të Kapitalit,
- **Ortaku SHOQERIA “USHINA” SHPK**, me NUIS K11717501T, kontribues me shumën **25.000 Leke**, që zënë **25%** të Kapitalit.

Neni 6:

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të Shoqerisë Tregtare “ADRIATIC UNION” shpk do të jenë Asambleja e Shoqerisë dhe Administratori i saj.

Fusha e veprimit, përberja dhe funksionimi i organeve drejtuese, emerimi dhe shkarkimi i anetareve dhe çështje të tjera të këtyre organeve rregullohen sipas Statutit të Shoqerisë, që është pjesë përberëse e këtij Akti, si dhe me dokumente të tjera të brendshme të shoqerisë që do të miratojë Asambleja e saj.

Neni 7:

Shoqeria Tregtare “ADRIATIC UNION” shpk do të administrohet nga 1 (një) administrator ligjor që është **Z. OLIVER USHINA**, atesia Fiqiri, i datelindjes 24.04.1979, shtetas shqiptar,

madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit *Leternjoftim ID 036046711/H90424029E*, i cili emerohet per nje periudhe **5 vjeçare**.

Administratori ka per detyre te realizoje administrimin e shoqerise dhe perfaqesimin e shoqerise tek te tretet si dhe ne gjykata, sipas percaktimeve te ketij akti themelimi, statutit, kompetencave te percaktuara ne Ligjin Nr.9901, dt. 14.04. 2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe kompetencave e detyrave te dhena posacerisht nga Asambleja e shoqerise.

Neni 8:

Shoqeria Tregtare "**ADRIATIC UNION**" shpk do te zhvilloje aktivitetin e saj sipas dispozitave normative urdheruese te Ligjit 9901, dt.14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionit tjeter te zbatueshem sipas llojit te veprimtarise dhe natyres se marredhenieve juridike, ne te cilat kjo shoqeri do te angazhohet.

Neni 9:

VULA E SHOQERISE

Shoqeria ka vulen e saj zyrtare me permbajtje: Shoqeria Tregtare "**ADRIATIC UNION**" shpk, Durres, Shqiperi.

Neni 10:

MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "**ADRIATIC UNION**" shpk rregullohen sipas dispozitave te Statutit te saj.

Neni 11:

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Viti financiar i shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti. Ne mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se shoqerise brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 12:

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale dhe te atyre ndaj te treteve, i ndahen ortakeve te shoqerise ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 13:

PRISHJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare "**ADRIATIC UNION**" shpk, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve te parashikuara ne Statut.



Neni 14:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Te gjitha kundershtimet eventuale midis ortakeve te shoqerise, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres. Mosmarreveshjet mund te zgjidhen edhe nga nje gjykate brenda apo jashte Shqiperise, ne rast se ortaket kane rene dakord midis tyre.

Neni 15:

NENSHKRIMI


Ky Akt Themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi lexohet me ze, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te Shoqerise tregtare **“ADRIATIC UNION” shpk** dhe nenshkruhet prej tyre ne te gjitha ekzemplaret, duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ADRIATIC UNION” shpk

Z.PETRIT KOVAÇI



SHOQERIA “T.O.V 2019” SHPK

Administratori

Genti Klosi



SHOQERIA “USHINA” SHPK

Administratori

Fatjon Ushina

